V E N D I M
Nr.440, datë 17.6.2001

PËR RREGULLAT PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E NJOFTIMEVE NË VEPRIMTARINË E INVESTIMIT NË LETRAT ME VLERË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 48 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë", ndryshuar me ligjet nr.8168, datë 5.12.1996 dhe nr.8745, datë 22.2.2001, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. (1) Në këtë vendim, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe:

- "Publikim" nënkupton çdo formë njoftimi, qoftë në formë deklarate, broshure, fletë palosje, reklame a lajmërimi, qarkoreje a dokumentesh të tjera ose nëpërmjet paraqitjes së fotografive, filmave, videove, transmetimeve radio-televizive nëpërmjet kompjutërve a materialeve të shtypura ose nëpërmjet shpërndarjes së regjistrimeve a në ndonjë forme tjetër;

- "Publikim për letrat me vlerë" nënkupton një publikim për a në lidhje me letrat me vlerë ose veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë.

(2) Në zbatim të këtij vendimi, një publikim i realizuar jashtë Shqipërisë do të trajtohet si i nxjerrë në Shqipëri, nëse:

u drejtohet personave në Shqipëri;

b) u vihet në dispozicion personave në Shqipëri, në mënyra të ndryshme nga publikimi i tij në një gazetë, të përditshme, revistë a botime të tjera të përditshme, të cilat publikohen dhe qarkullojnë kryesisht jashtë Shqipërisë ose nëpërmjet radios a televizionit, transmetimet e të cilëve drejtohen, kryesisht për jashtë Shqipërisë.

2.Kufizimet për publikimet

Me përjashtim të rasteve të përmendura në pikën 3, asnjë person tjetër përveç personave të licencuar nuk ka të drejtë të nxjerrë ose të përgatisë publikimin për letrat me vlerë në Shqipëri.

3. Përjashtimet nga kufizimet për publikimet

Pika 2 nuk zbatohet për:

(1) në publikim për letrat me vlerë, i nxjerrë ose që përgatitet të nxirret dhe që ka të bëjë vetëm letrat me vlerë të emetuara nga:

Qeveria e Shqipërisë ose qeveria e një shteti tjetër,

Banka Qendrore e Shqipërisë ose banka qendrore e një shteti tjetër.

(2) në publikim, i cili është një plan që duhet të regjistrohet nga Komisioni, sipas nenit 39 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë".

Përputhja e publikimeve me listën e kërkesave

Një person i licencuar nuk nxjerr apo përgatit nxjerrjen, qoftë në Shqipëri ose diku tjetër, të një publikimi për letrat me vlerë, nëse në këtë publikim nuk plotësohen kërkesat e mëposhtme:

I. Evidentimi i qartë i deklaratave

Në një publikim për letrat me vlerë nuk do të lejohet mosevidentimi, qartë e dukshëm, në raport me pjesën tjetër të publikimit ose përfshirja në të e materialeve të tjera, për të minimizuar rëndësinë e ndonjë deklarate a të materialeve të tjera, që kërkohen sipas dispozitave të këtij rregulli.

II.Publikimet duhet të jenë të qarta dhe orientuese.

(1) Përmbajtja e publikimit për letrat me vlerë dhe mënyra e paraqitjes së tij nuk duhet të lenë shteg për keqkuptime.

(2) Një publikim për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajë deklarim, premtim ose parashikim, nëse personi që e nxjerr atë nuk ndërmerr hapat e duhura për të siguruar shmangien e çdo keqkuptimi.

(3) Publikimi për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajë deklarim, në të cilin personi që e ka nxjerrë atë, në bazë të të dhënave që ka, nuk beson në vërtetësinë e tij.

(4) Nëse objekti për të cilin bëhet publikimi për letrat me vlerë është i disponueshëm në një masë të kufizuar, për një kohë të kufizuar ose, në kushte të veçanta, për një kohë të kufizuar, atëhere publikimi e thekson me këtë fakt. Kur vlerësohet se një gjë e tillë nuk është e nevojshme, atëhere nuk

përmban dyshime në lidhje me këtë.

III. Publikimet duhet të veçohen nga çështjet e tjera

(1) Publikimi për letrat me vlerë dhe mënyra e paraqitjes së tij kanë të qartë karakteristikat e një publikimi që ka për qëllim promovimin e letrave me vlerë, promovimin e veprimtarisë së investimit në letrat me vlerë ose të personave me të cilët lidhet ai.

(2) Nëse mjeti i informacionit, përmes të cilit kryhet publikimi, përmban ose paraqet çështje ose informacione të tjera, është e detyrueshme që publikimi të dalë qartë dhe të veçohet nga çështjet e tjera.

IV.Qëllimi real i publikimit

Publikimi i letrave me vlerë ka qëllim të krijojë bindje tek individët për objektin e publikimit. Nuk lejohet që publikimi të ketë qëllim krijimin e bindjeve tek individët për lidhjen e marrëveshjeve a për shërbime tregtare, që nuk përmenden në publikim.

V.Publikimet nuk duhet të lenë të nënkuptohet se gëzojnë miratimin e qeverisë ose të Komisionit.

Publikimet për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajnë ndonjë deklaratë nëpërmjet së cilës përcaktohet ose nënkuptohet se letrat me vlerë apo veprimtaria në letrat me vlerë janë miratuar nga qeveria apo Komisioni.

VI. Kërkesat për të qenë i hapur dhe i drejtë

Një publikim për letrat me vlerë që përcakton vetëm disa nga të drejtat dhe detyrimet për një investim në letrat me vlerë ose vetëm disa nga veçoritë dhe kushtet e një marrëveshjeje për veprimtaritë e investimit në letrat me vlerë, duhet:

(1) t'i përcaktojë ato në mënyrë të mjaftueshme, që t'i bëjë një paraqitje të qartë natyrës së investimeve në letrat me vlerë, të angazhimeve financiare, të ndërmarra nga investitori për përfshirje në investimin në letrat me vlerë, si dhe rreziqet që e shoqërojnë atë;

(2) të përcaktojë si sigurohet një deklaratë e tillë me shkrim.

VII.Krahasimi me investimet apo shërbimet e tjera

Një publikim për letrt me vlerë nuk duhet të krahasojë ose të ballafaqojë një investim në letrat me vlerë me një investim alternativ ose një shërbim për letrat me vlerë me një tjetër alternativë për rastet kur krahasimi dhe ballafaqimi është i hapur dhe i drejtë, në lidhje me atë që promovohet dhe duke patur parasysh çfarë është thënë dhe çfarë nuk është thënë, por që nënkuptohet.

VIII. Taksimi

(1) Një publikim për letrat me vlerë që i referohet taksimit duhet të përmbajë një paralajmërim se niveli dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë.

(2) Një publikim për letrat me vlerë, i cili përmban ndonjë çështje që bazohet mbi një normë të caktuar taksimi, duhet të përcaktojë kufijtë e normës.

(3) Një publikim për letrat me vlerë që u nënshtrohen lehtësirave nga taksimi:

a) duhet të përcaktojë se lehtësirat e përmendura janë ato që zbatohen sot për sot;

b) duhet të përmbajë një deklaratë që vlera e një lehtësie tatimore varet nga rrethanat e tatimpaguesit.

IX.Mbarëvajtja në të kaluarën

Një publikim për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajë të dhëna për mbarëvajtjen në të kaluarën për investimin në letrat me vlerë, përveçse kur:

(1) ai është i nevojshëm për mbarëvajtjen e investimit në letrat me vlerë, subjekt i publikimit;

(2) përcaktohet qartë burimi i informacionit;

(3) në të gjithë informacionin përcaktohet se:

a) gjithçka që përfshihet është përfaqësuese, e ndershme a jomashtruese;

b) lënia jashtë e atyre fakteve që nuk janë përmendur nuk jep efektin e ekzagjerimit të suksesit ose mbarëvajtjes gjatë periudhës me të cilën lidhet ky informacion;.

(4) informacioni i paraqitur në formën e grafikut ose të tabelës nuk lë pa përfshirë ndonjë pjesë, në mënyrë që të japë një përshtypje mashtruese për ndryshimin e treguesve të ndryshëm;

(5) periudha që është zgjedhur për ilustrimin e mbarëvajtjes në të kaluarën të jetë të paktën trevjeçare dhe të mbarojë jo më shumë se tre muaj përpara datës së nxjerrjes së publikimit;

(6) publikimi përmban një paralajmërim se mbarëvajtja në të kaluarën nuk shërben si referencë për të ardhmen.

X.Paraqitja e shkallës së veprimtarive

(1) Një publikim për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajë një deklarim, i cili paraqet shkallën e veprimtarive ose shtrirjen e burimeve të publikuesit ose të ndonjë grupi ku publikuesi është anëtar, për të krijuar përshtypjen se burimet e disponueshme, që shërbejnë për të mbështetur përmbushjen e detyrimeve të publikuesit, janë më të mëdha se në realitet.

(2) Deklaratat, që lidhen me burimet e anëtarëve të një grupi të ndryshëm nga publikuesi, duhet që ta paraqesin shprehimisht një fakt të tillë.

XI.Paralajmërimet për rrezikun

(1) Një publikim për lerat me vlerë sipas këtij paragrafi duhet të përmbajë një deklaratë ku nënvizohen rreziqet që shoqërojnë futjen në zotërim ose mbajtjen e letrave me vlerë, subjekt të këtij publikimi.

(2) Nëse publikimi ka të bëjë me një letër me vlerë, vlera në para e së cilës mund të ndryshojë, deklarata duhet të nënvizojë faktin se investitori mund të mos e rimarrë shumën e investuar.

(3) Nëse publikimi ofron një letër me vlerë që mund të sjellë të ardhura të larta ose që është e përshtatshme për një investitor, që kërkon fitime të larta nga investimi i tij, deklarata duhet të nënvizojë faktin se të ardhurat nga investimi mund ta ndryshojnë vlerën e tyre në para.

(4) Nëse publikimi lidhet me një letër me vlerë të emetuar në një monedhë të ndryshme nga ajo e vendit ku ka dalë publikimi, deklarata duhet të tërheqë vëmendjen për faktin se ndryshimet në kursin e këmbimit mund të shkaktojnë ulje ose ngritje të vlerës së letrës me vlerë.

(5) Kur publikimi për një letër me vlerë i jep të kuptojë investitorit, i cili hyn në një transanksion, se natyra e tij është e tillë që investitori mund të humbasë jo vetëm atë që paguan në fillim, por mund të jetë i detyruar të paguajë më vonë dhe shuma shtesë, të papërcaktuara, deklarata duhet ta nënvizojë këtë fakt.

(6) (a) Nëse letra me vlerë nuk tregtohet në një treg letrash me vlerë, të licencuara nga Komisioni, deklarata duhet të theksojë faktin se për këtë letër me vlerë nuk ka treg të licencuar dhe se investitori mund ta ketë të vështirë të shesë letrën me vlerë ose të sigurojë informacionin e duhur rreth vlerës së saj ose shkallës së rrezikut që ajo mbart.

(b) Nëse letra me vlerë tregohet në një treg të licencuar të letrave me vlerë, por tregtohet në mënyrë të parregullt dhe rrallë:

(I) që nuk mund të jetë i sigurt kuotimi i çmimit të saj gjatë gjithë kohës;

(II) që mund të jetë e vështirë të ekzekutohen transaksionet për ndonjë çmim që ajo mund të jetë kuotuar,

atëhere deklarata duhet të nënvizojë këtë fakt.

XII.Garantimi i të ardhurave

Në një publikim për letrat me vlerë nuk duhet që të ardhurat në vijim të investimit të paraqiten si të garantuara, të siguruara ose të premtuara, në çfarëdo mënyre, të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, me përjashtim të rasteve kur, para nxjerrjes së tij, është dhënë miratimi me shkrim, nga Komisioni.

XIII. Datimi

(1) Publikimi për letrat me vlerë në një gazetë duhet të ketë në cepin e poshtëm djathtas datën kur është nxjerrë për herë të parë.

(2) Publikimi për letrat me vlerë, nëpërmjet një plani, broshure, fletëpalosjeje ose literature të ngjashme marketingu, duhet të vendosë mbi kapakun e saj datën kur është nxjerrë për herë të parë.

(3) Publikimi për letrat me vlerë, i bërë nëpërmjet një filmi, videoje ose njoftimi televiziv duhet të paraqesë, në fillim ose në fund të materialit publikues, datën kur është nxjerrë për herë të parë.

XIV.Identifikimi i publikuesit

Një publikim për letrat me vlerë duhet të paraqesë personin e licencuar, i cili ka nxjerrë apo që bën të mundur nxjerrjen e publikimit, si dhe personin në emër të të cilit nxirret publikimi, kur ky i fundit është i ndryshëm nga personi i licencuar.

5.Urdhrat për publikimet

(1) Nëse Komisioni gjykon se një publikim për letrat me vlerë, i nxjerrë ose që përgatitet apo propozohet të nxirret nga një person i licencuar, është i rremë, Komisioni nëpërmjet një njoftimi me shkrim, i jep personit të licencuar një urdhër ndalues ose detyrues.

(2) Ky urdhër mund të përmbajë një, disa ose të gjitha ndalimet ose detyrimet e mëposhtme:

(a) ndalimin e nxjerrjes së një lloji të veçantë publikimi;

(b) detyrimin, që publikimet, të cilat kanë një përshkrim të veçantë, të ndryshohen sipas një

mënyre të caktuar;

(c) ndalimin e nxjerrjes së ndonjë publikimi i cili është tërësisht ose në pjesën më të madhe të tij, përsëritje e një publikimi të nxjerrë ose të propozuar për t'u nxjerrë një herë dhe që është përshkruar në urdhër;

(ç) detyrimin për të ndërmarrë në praktikë të gjithë hapat për tërheqjen nga qarkullimi apo paraqitja kudo të ndonjë publikimi apo të një prej publikimeve që kanë një përshkrim të veçantë, të specifikuar në urdhër;

d) detyrimin për një publikim të veçantë për publikimin e një korrigjimi të caktuar, në mënyrën dhe formën që përcaktohen nga Komisioni.

6.Dërgimi Komisionit të kopjeve të publikimeve

Komisionit i dërgohet një kopje e çdo publikimi për letrat me vlerë, të nxjerrë ose që përgatitet të nxirret nga një person i licencuar.

7. Kundërvajtjet në publikime

Një person i cili nxjerr ose përgatit nxjerrjen në Shqipëri të një publikimi për letrat me vlerë, nxjerrja e të cilit është ndaluar sipas pikës 2 ose që nuk përputhet me pikën 4, kryen shkelje dhe është i detyruar të paguajë një gjobë, në përputhje me dispozitat e nenit 63 të ligjit "Për letrat me vlerë"

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta